

Pjesorja, Paskajorja dhe Verbalet Tjera të Shqipes arbanika.com

Standardi '72 e njeh pjesoren si të pandryshueshme, por kjo nuk është e vërtetë; tingulli soster /r/ i këtyne trajtave vjen prej një prapashese. Paskajorja e tipit 'me punua' është paskajorja autentike e shqipes. Ajo nuk mund të zëvendësohet me fraza parafjalore të tipit 'për të punuar'. Në këtë tekst jepen format dhe përdorimet korrekte të pjesores dhe paskajores, dhe e përcjellores e mohores.

Këto trajta foljore mund të quhen edhe *folje të pashtjellueshme, folje të pashtjelluara, ose verbale*. Këtu ato quhen 'joscakajore' dhe përsipiqen me 'skakajoret', foljet që marrin mbaresa me u përshtatë me vetën e kryefjalës dhe me tregua kohën e veprimit a gjendjes.

Joscakajoret mund të quhen *folje të pashtjellueshme* sepse gjuhtarët mendojnë që ato janë të pazbërthyeshme (të pashtjelluara). Por, kjo nuk është plotsisht e vërtetë.

Pjesorja¹

Baza e joscakajoreve të gjuhës shqipe është pjesorja. Ajo del në dy trajta, 1) e pa-prapashtesuome, dhe 2) e prapashtesuome. Ndër shkrimtarët e parë, pjesorja delte kryesisht e prapashtesuome:

Buzuku dhe Budi: punuom

Matranga: punuur

Bogdani: punuem

Në qytezat e pushtuome prej otomanëve u pat zhvilluom edhe *Vernakulari Gegë*: punu.

¹ **Shenim:** format *-uar/uom/uem, -ur/un* janë të vona, mund të jenë formuom për analogji dhe mund të kenë tinguj zbutës në to, p.sh., /u/ në /ur, un/. Forma e lashtë e pjesores së shqipes mund të gjindet në gjakovishten 'banë', të cilën e ka edhe Buzuku. Ajo del edhe në pjesoren toske 'bërë'. Për më shumë shih historinë e gjuhës shqipe. Forma e lashtë e pjesores së shqipes nuk dihet me egzaktësi, por, në qoftë se shqipja e para 1000 vjetëve kishte paskajore, ajo mund të delte ~/dekë/, kurse pjesorja mund të delte ~/dekun/ ose diçka e përafërt.

Trajtat dialektore të pjesores së sotëme

Sot, pjesorja del e pa-prapashtesuome ose e prapashtesuome. Prapashtesat janë njëni prej treguesve kryesorë dialektorë të gjuhës së sotëme shqipe. Kur pjesorja sosë më *-r*, *-rë*, *-ur*, ajo është e prapashtesuome, e rotacizuome, dhe i përket dialektit toskë, ku përfshihen të folmet e trí fiseve kryesore të tosknisë: Lalët, Labët, e Çamët, si edhe Toskët e juglindjes (Korçë, Kolonjë, Pogradec, etj), vllahët e romët që jetojnë në jug të Shkumbimit, edhe Arbëneshët e Arvanitasit. Kur pjesorja sosë më togzanor, ajo i përket ose gegnishtes ose leknishtes.

Në hartën shoqnuese, shigjetat tregojnë shtrimjen e Lekëve (MM); ku flitet dialekti i quajtur 'leknisht', dhe ku togzanori kryesor i shqipes del uo/ua.

Leknisht: *punua* ose *punuo*

Gegnishte letrare: *punue*

Malsitë e Gegnisë lindore: *~punaue*

Vernakulari Gegë: *punu*

Tosknisht: *punuar*

LEKËT (Shtrimja e Malsisë së Madhe)



Paskajorja

Ata që vetë nuk e përdorin paskajoren, dhe të tjerëve u thonë që 'gjuha shqipe nuk ka nevojë për paskajore', janë si ngjyr-verbëtit të cilët thonë, 'ngjyrat nuk kanë randësi'. Fatkeqsisht, ata nuk mund ta kuptojnë nevojën për paskajore më shumë se ngjyr-verbëtit mund të kuptojnë nevojën për ngjyra. Çashtja këtu nuk është sipërfaqësore as stilistike, por thalbsisht kuptimore. Pa paskajore nuk mund të mendohet për *universalizma*. Lidhorja funksionon vetëm për *partikularizma*.

Megjithatë, prejse shkruesit e ligjruesit epranë vazhdojnë ta mohojnë nevojën e përdorimit të paskajores autentike të gjuhës shqipe, dhuntarët (talentet) e rí druhen se mos përdorimi i saj është jo vetëm shenjë mosbindieje ndaj etënve, por edhe shenjë padhuntie. Kështu gabimi bëhet normë.

Çashtja e paskajores autentike mbetet pothuaj tabu. Prandaj, ka gjuhtarë që mund t'i kushtojnë asaj vetëm pak rreshta, ose mund të mos e përmendin fare. Ka një botim të Nuhi Veselajt ku trajtohet çashtja e paskajores, por ku flitet më shumë për politikën e standardizimit të gjuhës dhe nacionalizmin tipik ballkanik sesa për nevojat gjuhsore të shqipfolësit. Mehmet Çeliku shkruan rreth paskajores në tekstin e tij *Foljet e Pashtjelluara të Gjuhës Shqipe*. Ka edhe disa vepra që trajtojnë gegnishten letrare, p.sh., gramatikat e Donat Kurtit e Justin Rrotës, ose gramatikat e shqipes historike, p.sh., ato të Kolec Topallit e Sh. Demirajt.

Në internet qarkullon një artikull i K. Cipos, ku në përpyekjen e tij me mbështetë Standardin '72, ai merr një shteg jo-akademik. Në vend që me argumentua se çka është paskajorja dhe se si përdoret ose si mund të përdoret ajo në gjuhën shqipe, ai argumenton që gjuhës shqipe nuk i nevojitet paskajorja.

Egziston edhe një supozim që paskajorja të formohet me pjesoren e prapashtesuar, p.sh., *me punuar*. Këtu ka një gabim gramatik. Tingullin /r/ në 'punuar' ka ngjehje të së kaluomes e të së kryemes, dhe ka natyrë pasive. Kurse paskajorja, p.sh., *me punua*, ka ngjehje të së tashëmes e të së pakryemes, dhe ka natyrë aktive; të fton me bënë diçka, p.sh.

Tokë e punuar (ngjehje të së kaluomes, të së kryemes, dhe pasives)

Duhet me punua (ngjehje të së tashëmes, të së pakryemes, dhe aktives)

Krahasoju fjalitë pasuese:

× Erdha me punuar tokën e papunuar.

√ Erdha me punua tokën e papunuome.

√ Erdha me punua tokën e papunuar.

Çka është pa-SKAJ-orja?

Paskajorja është një verbale, një trajtë foljore e pashtjellueshme. Ndryshe prej pjesores që mund të zbërthehet në rranjë dhe prapashtesë, p.sh., punuo-m/r, paskajorja nuk mund të zbërthehet në përbasë më të vegjël. Ajo ka vetëm një formë, p.sh., *me punua*, *me thye*, *me çie*, *me hjekë*, *me mib*, *me bâ*, *me rá*, *me luajt*, e të tjera.

Paskajorja i ruan veçsitë e foljes, por nuk mund të zgjedhohet me iu përshtatë kryefjalës në vetë e numër, as nuk mund të ndryshojë me tregua kohën e veprimit a të gjendjes. Kështu, tipikisht, paskajorja del sëbashku me një folje tjetër -- një folje primare (pasë, qenë), një folje modale (mund, duhet), ose në një strukturë katenative. Në të gjitha këto struktura, janë foljet tjera ato që zgjedhohen, jo paskajorja, p.sh.,

Ke *me ardhë heret*. Ka *me ardhë vonë*.

Marteli ishte *me thye gurë*. *Martelët* isbin *me thye gurë*.

Nuk mundi *me ecë*. *Nuk* mundën *me ecë*.

Mendoj me folë *para se t'i vinte radha*.

Por, paskajorja ka edhe përdorime të tjera. Prej kandvështrimit morfologjik, ajo mund të përdoret si *emën*, *mbiemën*, ose *ndajfolje*. Kurse, prej kandvështrimit sintaksor, ajo mund të funksionojë si *kryefjalë*, *kundrinë*, ose *komplement*².

² Termi 'komplement' përkon me strukturën sintaksore të anglishtes. Ai përdoret në këtë gramatikë të shqipes, por gjuhëtarët tjerë shqiptarë përdorin terma të tjera.

Si formohet paskajorja

Paskajorja formohet duke gramatikalizua parafjalën ‘me’ me pjesoren e pa-prapashtesuome, p.sh., p.sh., *me luajt, me djegë, me dalë, me marrë, me shkrua*. Kjo endsi quhet e gramatikalizuome ose e ngurtsuome sepse, këtu, parafjala ‘me’ funksionon si pjesë e paskajores, jo si parafjalë.

Format e paskajores

Paskajoret e shkrimtarëve të parë dhe paskajoret e shkrimtarëve të sotëm ndryshojnë në një pikë: shkrimtarët e parë e përdornin atë të prapashtesuome, kurse shkrimtarët e sotëm e përdorin atë të paprapashtesuome. Këtu, errtimi bjen mbë shkrimtarët e parë.

Paskajorja e shkrimtarëve të parë

Buzuku e Budi: *me punuom*

Matranga: -

Bogdani: *me punuem*

Shembujt e mësipërm tregojnë që gegnishtja letrare vjen prej Bogdanit, toskrishtja letrare prej Matrangës, dhe se leknishtja e krajishtja dalin afër gjuhës së Buzukut.

Paskajorja e sotëme

Sot, paskajorja e gjuhës shqipe del afërsisht në katër trajta.

Në leknisht: *me shkrua / me shkrue*

Në gegnishten letrare/Dukagjin-Tropojë-Has: *me shkrue*

Në malsitë gege: *~me shkraue*

Në vernakularin gegë: *me shkrue*

Në tosknisht: -

Paskajorja e Standardit 1972

Zyrtarisht, standardi '72 nuk ka paskajore, por kjo verbale mund të nxirret prej trajtave foljore të vetë këtij standardi në vetëm tre hapa:

1. E tashëmja veprorë: *unë **shkrua**-j, ti **shkrua**-n*
2. E kryera e thjeshtë joveprorë: *Letra u **shkrua***
3. Paskajorja: ***me shkrua***

Këtë muaj, gruaja juaj u punsua me revistën tonë sepse ajo dinte me shkrua.

Në këtë fjalí, e cila mund të përdoret prej një bariu Rugovas ose Kelmendas, i vetëmi ndryshim që i bâhet standardit '72 është shtimi i paskajores. Prandaj, pyetja është: *përse nuk i shtohet këtij standardi paskajorja autentike e shqipes?*

Çashtja e togzanorit ua/ue dhe rotacizimit

Më -ua(r)/-ue sosin ~70% e foljeve të gjuhës shqipe. Ato sjellin çamjen mǎ të thellë në mes të gegnishtes e tosknishtes, p.sh.,

leknisht: *e gëzuome, në mënyrë të gëzuome, u gëzua, me gëzua*

tosknisht: *e gëzaruar, në mënyrë të gëzaruar, u gëzarua, -*

gegnisht: *e gëzeueme, në mënyrë të gëzeueme, u gëzeue, me gëzeue*

1. Shumica e paskajoreve të tjera mund të pranohen krejt lehtëazi prej standardit '72, p.sh., *dëshiron me ardhë; nisën me luajt; shkuan me prë biletën.*

2. Ndërsá ata që nuk e kuptojnë randsinë e paskajores, kanë arsye të mjaftueshme mos me e përfshí atë në ligjratat e shkrimet e tyne, shtetet shqiptare nuk kanë arsye mos me e zyrtarizua këtë formë të paskajores. Në fund të fundit, askush nuk duhet të detyrohet ta përdori atë. Por, standardi i gjuhës shqipe nuk mund të shtyhet mǎ tej pa paskajore.

Përdorimi i Paskajores në Gjuhën Shqipe

Paskajorja përdoret si *verbale* (një tip folieje), *emën*, *mbiemën*, dhe *ndajfolje*. *Si verbale* ajo del në endsitë katenative (katenë = vargzim, lidhje e pazgjidhëshme) dhe në klauzat me paskajore, ku kryefjala nënkuptohet. *Si emën* ajo mund të funksionojë si kryefjalë, kundrinë, ose komplement i kryefjalës dhe kundrinës së drejtë. Paskajorja *si ndajfolje* ose *si mbiemën* shërben si modifikuese fjalësh tjera.

I. Paskajorja si emën

Me vërtua që paskajorja (infinitivi) përdoret si emën, zëvendsoje atë me një përemën.

1. *Paskajorja si kryefjalë*: **Me kursye** është mirë. (diçka është mirë.)
2. *Si kundrinë*: Ai donte **me folë**. (donte diçka)
3. *Si komplement*: Qëllimi i saj ishte **me blé** (ishte diçka). Sytë janë **me pā** (janë për diçka).

II. Paskajorja si mbiemën

Paskajorja e përdorun si mbiemën, zakonisht, del pas emënit që ajo modifikon.

4. *Si përshkuese e kryefjalës*: Libri **me blé** është 'Epika Shqiptare'.
5. *Si përshkuese e kundrinës*: Ia ndaloi të drejtën **me bā** bé.

Në 4., paskajorja 'me blé' modifikon emënin 'libri'. Në 5. paskajorja 'me bā' modifikon emënin 'të drejtën'.

III. Paskajorja si ndajfolje:

Në këto endsí, paskajorja i përgjigjet pyetjes 'pse'. Ajo mund të jetë një klauzë e varun që modifikon klauzën kryesore, dhe mund të vendoset para ose pas klauzës që ajo modifikon.

6. *Para klauzës kryesore*: **Me pā** (pse?) zjarret e Shninëzave, Lula shkoi në Zadrimë.

7. Pas *klauzës kryesore*: Lula shkoi në Zadrinë **me pā** (pse?) zjarmet e Shrinëzave.

Paskajorja e integruome në disa endsí tipike

8. Në kohën e ardhëme: *Veskleva ka me arritë në kohë.*

9. Në kushtore: *Shtojza deshi me ardhë por u bā vonë.* | *Bane me nisë, s'mund të ndalesh.*

10. Në folje që shenjojnë progresin e veprimit: *Martini nisi me folë; Filja vazhdoi me ecë.*

11. Me folje katenative: *Luka vendosi me vjelë dardha.*

12. Me folje qëllimore: *Martini shkoi me pa ndeshjen.*

13. Në endsí krahasuese me 'sa': *Lula hangri sa me thanë.* | *Punonte aq sa me fitua jetesën.*

14. Në endsí krahasuese me 'se': *Autobuzi u ndal para se me arritë te Kroni i Bogës.*

15. Në pyetje: *Kur deshe me u nisë?*

16. Në endsí mohore: *S'don me ardhë.*

17. Në nxitje: *Ban mirë me hapë derën.*

18. Kur folja dhe kryefjala këmbëjnë vendet: *Asht vonë me nisë prej fillimit.* (Çka është vonë?)

19. Me folje modale: *Ajo nuk mundet me fjetë. Atij i duhet me ardhë.*

Klauzat me paskajore

S'pari, lexo shembujt pasues:

1. Paskajorja ka trajtë aktive dhe pasive.

aktive: *Asht e vështirë me pá në terr.*

pasive: *Asht e vështirë me u pá në terr.*

2. Paskajorja nuk ka trajtë vazhduese

Vazhdimsia me paskajore nuk mund të arrihet sepse paskajorja nuk mund të dali pas pjesëzave 'po, duke, tue, tuo'.

a) Po lexoj. Po lexon; **po** me lexua

b) Jam duke lexua. Æsht duke lexua; Æsht me lexua

3. Paskajorja i formon kumtet negative duke u prË prej pjesëzës ‘mos’.

aktive: *Æsht e vështirë **mos** me pá në dritë.*

pasive: *Æsht e vështirë **mos** me u pá në dritë.*

4. Modalet, jo paskajorja, zgjedhohen

Mundem me lexua. Mundet me lexua.

Dua me lexua. Do(n) me lexua.

5. Gjysmë-modalet nderrojnë; paskajorja jo

Kam me lexua. Ka me lexua.

Struktura e klauzave me paskajore

Prejse klauza duhet me pasë kryefjalë e kallzues, disa besojnë që ky tip klauze nuk egziston. Por, shpjegimet pasuese tregojnë që ata mund të jenë gabim.

S’pari, vërej shkurtimet.

K - kryefjalë

F - folje

Kn - kundrinë; **Kn_d** - kundrinori i drejtë; **Kn_t** - Kundrinor i tërthortë

Kp - komplement; **Kp_k** - komplementi i kryefjalës; **Kp_{kn}** - komplementi i kundrinës (së drejtë)

N - ndajfoljor (rrethanor)

Shembuj:

Shtat endsitë pasuese përkojnë me Quirk et, al, por autorët e këtij teksti nuk e qartsojnë që emëni që del si kundrinor i drejtë i foljes skajore nënkuptohet edhe si kryefjalë e klauzës me paskajore.

1a. *Ai e ftoi Platorin me u kthye.*

Këtu trajta 'Platorin' funksionon si kundrinor i drejtë i foljes skajore.

1b. KF (SV): *Platori^(K) me u kthye^(F).*

Këtu trajta 'Platori' funksionon si kryefjalë e paskajores. Por në komunikim, kjo kryefjalë lehet jashtë sepse fjalia ngushtohet, ose kompaktohet, çka është një feonmen i zakonëshëm sintaksor.

Ai e ftoi Platorin me u kthye.

Ai e ftoi Platorin^(kd) [që] Platori^(k) me u kthye.

Kë? Platorin. Kush me u kthye? Platori

2. *Ata na thanë me vizitua Rugovën.*

KFKn (SVO): *[që] Ne^(K) me vizitua^(F) Rugovën^(Kn_d).*

3. *Ju e mësuar djalën me qenë i sjellëshëm.*

KFKp (SVC): *[që] Djali^(K) me qenë^(F) i sjellëshëm^(Kp).*

4. *Është mirë për të gjithë me qenë këtu.*

KFN (SVA): *Të gjithë^(K) me qenë^(F) këtu^(N).*

Është mirë për të gjithë [që] Të gjithë me qenë këtu.

5. *Është e drejtë për ty me i thanë asaj një fjalë të mirë.*

KFKnKn (SVOO): *Ti^(K) me i thanë^(F) asaj^(Kn_f) një fjalë^(Kn_d) të mirë.*

6. *Etuta të tha me e bërë limonatën të ëmbël.*

KFKnKp (SVOC): *Ti^(K) me e bërë^(F) limonatën^(Kn_d) të ëmbël^(Kp_{kn}).*

7. *Ajkuna e ftoi Gjelinën me e vû kunorën mbë krye.*

KFKnN (SVOA): *Gjelina* ^(K) *me e vû* ^(F) *kunorën* ^(Kn) *mbë krye* ^(N).

Klauzat me joskajore ngushtojnë (kompaktojnë) kumtin

1. Paskajoret, mohoret, dhe përcjelloret mundësojnë ngushtimin e kumteve sepse ato hijezojnë informacionin që mund të nënkuptohet prej rrethanave kumtore.

a) I thashë me ju telefonua.

b) I thashë atij që ai t'ju telefononte ju.

2. Ngushtimi ndodhë edhe me elementin e kryefjalës.

a) Me qenë besnik është e vështirë.

b) Që përsoni të jetë besnik është e vështirë.

3. Në këto rrethana, forma e ngushtuome me lidhore 'ngushton' edhe kumtin, sepse ajo e kthen aforizmin në një këshillë përsonale; shpesh në një patronizim. Kjo është e padëshirueshme sepse disa e shohin patronizimin si shkaktues ndrydhjesh psikologjike.

Ven re shembullin tjetër:

a) Me qenë besnik është e vështirë.

b) Të jesh besnik është e vështirë.

Në a) kumtuesi flet për të gjithë, por më shumë për vetveten, prandaj ky kumt nuk është patronizues. Kurse në b) kumti është patronizues (ndrydhës).

Por, në fjalitë me përcjellore, ngushtimi i kumtit mund të përmbajë pak megjullsi:

E takuam të birin duke hipë në tren.

Kush po hipte në tren: i biri, apo përsonat që e takuan atë?

Pseudo-paskajorja

Buzuku nuk e përdorë endsinë e tipit 'për të punuom' (K. Topalli), e cila në tosknisht del 'për të punuar'; dhe në gegnisht mund të dali 'për të punue' ose 'për me punue'. Por, ai e përdorë atë në një mënyrë tjetër; në mënyrën korrekte të gjuhës shqipe: parafjalë + emën asnjëanës + emën/përemën në gjinore , p.sh.

për + të lutunatë + [e]/të saj

-- Buzuku, Meshari, Botim Kritik, 35

Kjo endsí nuk është paskajore (verbale) sepse:

- Foljet nuk marrin parafjalë; 'për' është parafjalë
- Emëni i këtyne endsive shquhet, p.sh., 'të punuom > të punuom-it'; foljet nuk shquhen.

Edhe në standardin e sotëm: për të punuar

'për' është parafjalë e pagramatikalizuome

'të punuar' është emën asnjëanës; ai mund të lakohet, p.sh.

'të punuar, të punuarit, prej të punuarit'

Përcjellorja

Përcjellorja pason një trajtë të foljes 'qenë'. Në disa endsí, ajo është dublim i aspektit të vazhdimsisë, i cili formohet me pjesëzën 'po' dhe një trajtë të së tashmes ose të së pakryemes.

1. Ajo është **duke/tue vozitë**.

E tashmja e vazhdueshme: *Ajo po vozitë*.

2. Ajo ishte **duke/tue vozitë**.

E pakryemja e vazhdueshme: *Ajo po voziste*.

3. Ajo qe **duke/tue vozitë**.

Krahasimi i përcjellores me pjesoren e anglishtes

Në fillim të fjalisë, përcjellorja mund t'i afrohet pjesores së kohës së tashme të anglishtes.

Waiting too long, she got tired.
Duke pritë tepër gjatë, ajo u lodh.

Krahasimi i përcjellores me gjerundivin dhe gjerundin

Disa e afrojnë përcjelloren me gjerundivin e frangjishtes.(?)
Përcjellorja e shqipes nuk duhet njësuom me gjerundin e anglishtes.

Mohorja

Mohorja kumton mohim (është privative), prandaj ajo nuk mund të përdori pjesëza të tjera mohuese. Si formë, ajo është e kundërta e përcjellores, p.sh.,

Duke ecë shpejt arrin në kohë.

Pa ecë shpejt nuk arrin vonë.

Të tjera

Tipikisht, endsitë pasuese kanë mbetun të paemnuome.

Me të hapun derën, ai hyni.

Një të hapun derën, ai hyni.

Referencat

Kolec Topalli, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë*, Tiranë, 2011

Bahri Beci, *Të folmet veriperëndimore të Shqipërisë dhe sistemimi fonetik i së folmes së Shkodrës*, Akademia e Shkencave e RSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1995

Mehmet Çeliku, *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë

Nuhi Veselaj, *Paskajorja gëshije e shqipes standarde ; (vështirim sinkronik)*Tiranë, 2000

Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe. I.*, Tiranë 1973; II., Tiranë 1976

Justin Rrota, *Gjuha E Shkrimeve Ase Verëjtje Gramatikore*, Botome Françeskane, Shkodër, 2014

Donat Kurti, *Gramatike Shqipe*, Botome Françeskane, Shkodër, 2020

Ilia Dilo Sheperi, *Gramatika dhe Sindaksa e gjuhës shqipe*, Romë, 1972

Gramatika e Institutit të Gjuhës e Letërsisë, Vëllimet I dhe II, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002

Texts in English

Martin Camaj, *Albanian Grammar With Exercises, Chrestomathy and Glossaries, Collaborated on and Translated by Leonard Fox*, Otto Harrassowitz, Wiesbaden, Germany, 1984

Randolph Quirk, Sidney Greenbaum, Geoffrey Leech, Jan Svartvik, *A Comprehensive Grammar of the English Language*, Longman, Standard Edition, January 1, 1989.